Procesverbali I mbledhjes date 30.05.2025

Sot ne sallen e mbledhjeve te Keshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e rradhes sipas njoftimit te dates 16.05.2025. Te pranishem ne salle : Alfredi Gjata, Valbona Spaho, Imelda Cucka, Oljana Comka, Esmeralda Medolli, Oliver Mulla, Vladimir Gjyli, Eduard Maho, Vladimir Kello, Festim Kaso, Lindita Cokani

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 1. Rendi i dites "miratimi i rendit te dites."

Hapet votimi 11 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 2 "Miratimi i procesverbalit te dates 29.04.2025.

Hapet votimi 11 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 3. Projektvendimi Nr 24 date 21.03.2025 " Per dhenien ne perdorim te siperfaqes prej 7,54 HA ne fondin pyjor/kullesor per instalimin e panelve me energji diellore fotovoltaike.

Orgesti Cenolli: Ne zhvilluam konsultimet ne fshatin Bitincke pasi pozicionimi i parceles eshte pjese e Bashkise, pra pjese e fondit pyjor dhe kullosor te Bashkise.Edhe pse supjekti ka kerkuar me teper siperfaqe, raporti teknik u be per 7,54 HA,pasi prekte disa siperfaqe te cilat nuk ishin te fondit tone.Raporti teknik si fillim hartohet mbi nje baze kerkese me pas projektvendimi pasi rreg numer 1 eshte qe keto siperfaqe jepen me ankand , kjo siperfaqe interesohet nga nje subjekt dhe atij i duhet te nise procedurat dhe ne nuk mund te lidhim kontrate drejtperdrejt me te.

Vladimir Gjyli; Per mendimin tim duke marre shkas edhe nga mendimet nga banoret e fshatit Bitincke gjate konsultimeve publike ne te cilen pjesmarrja ishte e vaket , nuk mendoj qe duhet te miratojme kete pv pasi ndodhet edhe shume afer fshatit dhe nuk dua qe mbas shum kohesh , te kemi konflikte me njerzit te cilet jetojne atje,.

Vladimir Kello: Paraqet nje kerkese me shkrim ne te cilen kundershton miratimin e ketij vendimi duke shprehur qartesisht mungesen e banoreve te fshatit gjate konsultimeve publike, kerkesa i dorzohet sekretares se keshillit pasi lexohet me ze te larte .

Mbas nje debati keshilltari Vladimir Kello largohet nga mbledhja,

Imelda cucka: Mendoj qe lajmerimi per konsultimin publik duhet te ishte bere duke ngjitur njoftimet neper fshat qe te gjithe njerzit te ishin te informuar ,

Alfredi Gjata: Njoftimi i eshte dhene administratorit te fshatit per tu marre me organizimin e ketij konsultimi ,

Ne salle vjen keshilltari Genti Demcolli

Eduard Duro: Mendoj te bejme konsultime per te gjithe keto toka te cilat do te jepen me qera per nje arsye, per ti pasur paraprakisht dhe per te mos patur probleme me vone.

Alfredi Gjata: Nuk ka kuorum per te kryer votimin,vazhdojme me projektvendimin nr 31.date 16.05.2025 " Per miratimin e ndihmes ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6 % per bllok-ndihmen ekonomike per muajin Prill 2025 .

Nuk ka diskutime ne lidhje me kete pv.

Imelda Cucka largohet nga salla duke shprehur miratimin e te gjitha pv paraprakisht.

Hapet votimi 11 pro 0 kunder 0 abstenim .

Alfredi Gjata: Vazhdojme me Pv nr 32 dat 16.05.2025 " Per miratimin e ndihmes financiare per perballimin e shpenzimeve te varimit nga fondi rezerve i Bashkise per qytetare ne nevoje"(zoti Pellumb Becolli, znj Elda Muci)

Genti Demcolli: Meqenese jemi ne kete lloj pv dhe diskutimi dua te di nese per varrezat ka ndonje rregullore per sa i perket zaptimit apo rrethimit te tyre .

Oliver Mulla: Ketu ne qytetin tone kane qen gjithmon te ndara me fise dhe ka vite qe funksionon keshtu .

Eduard Duro: Si edhe e tha parafolesi ka shum vite qe funksionon keshtu dhe Bashkia nuk ka nderhyre asnjehere

Eduard Maho: Per sa i perket shifrave qe jane neper keto fatura mendoj qe te kete nje tavan dhe te jete e njejta tarife per te gjithe.

Eduard Duro: Tani farurat vijne nga angjesite funerale por kjo sdo te thote qe marin pagesen e plote ,

Hapet votimi: 11 pro 0 kunder 0 abstenim .

Alfredi Gjata: Vazhdojme me Pv nr 33 date 16.05 .2025 "Per ngritjen e grupit teknik te punes ne Bashkine Devoll per projektin e strategjise vendore te vleresimit te riskut nga fatkeqesite .

Ylli Stena : Strategjia vendore e vleresimit te riskut nga fatkqesite ka te beje me zbatimin e politikave dhe strategjive per zvogelimin e riskut te fatkeqesive , per te parandaluar riskun e ri , per te zvogeluar riskun ekzistues dhe per te menaxhuar riskun e mbetur duke ndihmuar ne forcimin e vetperteritjes dhe zvogelmin e humbjeve ne rast fatkeqesie. Ne kete dokument behet

nje analize per te percaktuar natyren dhe shkallen e riskut nepermjet analizes se risqeve te mundeshme dhe vleresimit te kushteve egzistuese dhe ekspozimit dhe cenueshmerise qe se bashku mund te demtonin njerzit , pronen , sherbimet , jetesen dhe mjedisin e ekspozuar nga i cili ato varen.

Hapet votimi 11 pro 0 kunder 0 abstenim , nuk ka me diskutime te tjt mbledhja deklarohet e mbyllur .

Kostandine Broholli

Officedi Gjoka